



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1122/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Fejzullah Rexhepi, Rafet Haxhaj, Nenad Lazić, Afijete Sada-Gllogjani, Zyhdi Haziri, dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Vasilika Zotaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër Raportit të kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 01.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli i parashtruar nga Vasilika Zotaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër Raportit të kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 30.11.2017, ka pranuar një apel nga Vasilika Zotaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, me të cilën e konteston vendimin e KQZ-së lidhur me certifikimin e rezultatit përfundimtar për asamble komunale ne Kuvendin komunal ne Prishtinë të datës 29.11.2017 për shkak se siç thekson vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të ligjit për zgjedhje pasi që ka certifikuar listën përfundimtare për asamble komunale ne kuvendin komunal ne Prishtinë. Parashtruesja e apelit thekson se ne rezultatet preliminare ajo ka dal si kandidatja e pestë në kuadër te listës zgjedhore te AAK-së. ndërsa me rastin e numërimit të votave të disa kandidatëve tjerë i është mohuar e drejta e saj që e njëjta të paraqes faktet që e bazojnë rezultatin e saj e as nuk i është dhënë mundësia qe e njëjta të mund te përcjell rregullsinë e rinumërimit apo verifikimit të numrit të votave nga kandidatët tjerë.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë së apelit, gjeti se:

apeli është i palejuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apelueses gjeti se apeli i parashtruar nga Vasilika Zotaj kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik AAK, është i palejuar pasi që me datën 29.11.2017 KQZ në bazë të nenit 106 par.1 të LZP-së, ka bërë certifikimin e rezultateve për anëtarë të kuvendeve komunale, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotim dhe në qendrën e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga PZAP-i dhe nga Gjykata Supreme.

Pretendimet ankimore të apelueses, që janë të parashtruara ndaj vendimit të KQZ-së mbi certifikimin e rezultateve në këtë rast të anëtareve të Kuvendit Komunal, është vendim i pa ankimueshëm, ne kuptim të nenit 106 par.3 të LZP-së, në të cilin parashihet se *“Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja”*. Që do të thotë se Vendimi i KQZ-së për rezultate përfundimtare mund të ankimohet, por nuk mund të ankimohet vendimi për certifikim të rezultateve siç është rasti i apelit të parashtruar nga Vasilika Zotaj.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1122/2017 me datën 01.12.2017



Kryesuesi i Panelit

Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa